

ONLINE WORKSHOPS



Të nderuar/a,

Po ua paraqesim programin e aktiviteteve të punës me të rinjtë, të moshave 14 deri në 16 vjeç, me të cilin kemi kaluar në platformat online për t'u përshtatur me rrethanat në zhvillim të luftimit të pandemisë së virusit korona, kur ne jemi të detyruar të mbrohemi duke qëndruar në shtëpitë tona.

Aktivitetet online zhvillohen në platformën Zoom me ndihmën e Grupit në Viber për komunikim të rregullt me një grup prej 40 nxënës nga shkollat tona partnere në Bujanoc në kuadër të projektit “Qyteti ynë, shkollat tona”, i implementuar nga Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat e Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe Grupi 484, me mbështetje nga Fondacioni i Fëmijëve Pestalozzi nga Zvicra.

Programi i punëtorive është krijuar nga trajneret tona: Jellena Rangjeloviq dhe Sanja Stamenkoviç të cilat i falenderojmë për idetë e shkëlqyera!

Shpresojmë që këto ide t'i shërbejnë edhe të tjerëve në të ardhmen dhe të shërbejnë si inspirim për punë online me të rinjtë!

PUNËTORIA I

LETËR SHOKUT NGA NJË QYTET/SHTET TJETËR

Në letër ndani disa informacione interesante rreth vetes dhe se si e kaloni kohën në shtëpi në. Në shoqërimin tonë online ne biseduam me nxënësit se nëse ata i kanë dërguar ndonjëherë letër diku, lexuam pjesët më interesante të letrave që u shkruan miqëve që duhej të njiheshin gjatë shkëmbimit ndërkulturor në Zvicër, dhe u munduam ta gjejmë se kush e ka shkruar atë letër. Letrat i kemi dërguar me email shokëve nga Zvicra, duke iu premtuar se do të dërgojmë me postë letrat kur situatën pandemike ta kemi nën kontroll.

PUNËTORIA II

DITARI I FOTOGRAFIVE

Fëmijët udhëzohen të regjistrojnë përmes telefonave të tyre një ditë në izolim, një javë (përzgjedhja e 10 fotove) me tema të ndryshme - shkolla, ushtrime, koha e lirë, të ushqyerit, këndi preferuar. Ekziston mundësia e një ditari fotografik tematik, ku fëmijët do të zgjidhnin që gjatë javës të fotografojnë vetëm detajet që lidhen me temën të cilën e kanë përzgjedhur.

PUNËTORIA III

INTERVISTË ME ANËTARËT E FAMILJES

Fëmijët zgjedhin një anëtar të familjes për të intervistuar se si ata dikur e kalonin kohën në shtëpi (për shembull, lojërat e preferuara “dikur dhe tani”, ritualet e preferuara në familje), por gjithashtu kanë mundësi të zgjedhin temën për intervistën. Së bashku me anëtarët e familjes, ata mund ta luajnë një lojë të cilën do t’ia prezantojnë shokëve në takimin online.

PUNËTORIA IV

FJALORI YNË I VOGËL

Nxënësit në grupe të vogla (nga 5 nxënës) eksplorojnë se cilat fjalë janë të njejta në serbisht, shqip dhe në gjuhën rome. Secili grup ka për detyrë të mësojë të paktën 5 fjalë në dy gjuhët e tjera. Fjalori mund të plotësohet më vonë. Grupi ynë i nxënësve është i përbërë nga nxënësit me kombësi serbe, shqiptare dhe rome, por ju mund t’i përshtatni këtij aktiviteti grupit me të cilin punoni. Sfidat e të mësuarit të një gjuhe janë gjithmonë interesante.

PUNËTORIA V

PAMJA NGA DRITARJA IME

Puna në çift. Një nxënës ka për detyrë të fotografojë pamjen përmes dritares dhe atë fotografi t’ia përshkruaj partnerit të tij në çift i cili ka për detyrë që atë që e dëgjojon ta vizatojë. Rolet ndërrohen më vonë. Fotografitë dhe vizatimet dërgohen para punëtorisë në grupin e Viberit, ku do ti bashkojmë çiftet (fotografinë dhe vizatimin e fotografisë), dhe në punëtorinë online në platformën Zoom, ky aktivitet është një hyrje në një diskutim se si i përceptojmë gjërat ndryshe.

PUNËTORIA VI

VIZITË VIRTUALE MUZEVE APO GALERIVE

Nxënësit marrin një link nga interneti para punëtorisë për të vizituar një muze ose galeri të caktuar. Gjatë punëtorisë online, ata flasin për përshtypjet, sa i rëndësishëm është arti në jetën e tyre, nëse ata kanë vizituar ndonjë muze më parë, cilët, çfarë do të dëshironin të vizitonin me të vertetë, çka iu ka pëlqyer më shumë gjatë vizitës virtuale. Gjithashtu mund të organizoni një kuiz të shkurtër dhe interesant për të testuar njohuritë nga vizita virtuale!

PUNËTORIA VII

RRUGËT E SË VËRTETËS

Nxënësit marrin dy lajme të rreme dhe të vërteta në lidhje me situatën aktuale të pandemisë së koronavirusit. Gjatë punëtorisë, diskutohet rreth edukimit mediatic, rëndësia e njohjes së një burimi të rëndësishëm të informacionit, qëndrimi ynë për marrjen e informacionit dhe rëndësia e të menduarit kritik.

PUNËTORIA VIII

SIGURIA NË INTERNET

Bashkëpisedim me nxënësit rreth sjelljes së tyre në internet, cilat aplikacione i përdorin, rëndësia e ruajtjes së të dhënave, gjuha e urrejtjes, ngacmimet, dhuna në internet, kujt mund ti drejtohen për mbrojtje, ku ta paraqesin dhunën. Gjithashtu para punëtorisë mund te veçoni shembuj ku siguria e të rinjëve në internet është e rrezikuar dhe të dëgjojmë se çka mendojnë të rinjtë rreth atyre shembujve.

PUNËTORIA IX

MYSAFIRI

Zgjedhja e mysafirit mund të jetë e ndryshme nga rëndësia e personit, nxënësit, psikologut...

PUNËTORIA E X

TREGIMI I PA FUND (DASHURIA NË EPOKËN E KORONËS)

Shkruarja e poezive apo tregimeve në mënyrë që nxënësit të lidhen duke thënë fjalë / fjali njëra pas tjetrës.

PUNËTORIA XI

LESIKONI

Nxënësit marrin një listë të pyetjeve të cilat duhet t`i përgjigjen (cila është gjëja më interesante që keni bërë gjatë javës, oila është më e mërzitshja, sa më së shumti keni fjetur, oili nga postimet tuaja ka më shumë pëlqime, sa herë keni larë duart ...). Ne do t`i bashkojmë të gjitha përgjigjet dhe do të marrim një leksik të përbashkët dhe do të diskutojmë përgjigjet e marra në punëtori.

PUNËTORIA E XII

UNË KAM TALENT

Nxënësve iu jipet detyra të na prezantojnë shkurtimisht disa prej talenteve të tyre (këndimi, pikturimi, vizatimi, gatimi, kozmetika, repimi, gjumi....)

PUNËTORIA XIII

DITARI HULUMTUES

Nxënësit regjistrojnë për një javë atë që mendojnë se është e rëndësishme, vëzhgojnë veten, gjuhën e trupit, ndjenjat, aromat, çfarë i tërheq tek të tjerët dhe çfarë i largon, çfarë reagimesh ose sjelljesh i pëlqejnë / nuk i pëlqejnë, si reagojnë për atë që është ndryshe nga unë, çka më shumë që tani vërej / në çka jam mirënjohës në fund të ditës .. dhe në online punëtorinë ne ndajmë përvoja nga ky ushtrim.